



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 18.11.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 14.11.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Papenburg Adriani për aktivitetin: "Rikonstruimi i rruges Isa Kastrati" dhe me numer të prokurimit 616 20126 521 nxjerr:

V E N D I M

1. Apropohet **kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Papenburg Adriani "e datës 14.11.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit" Rikonstruimi I rruges Isa Kastrati" dhe me numer të prokurimit 616 20 126 521 kundër njoftimit të vendimit të AK –së, të publikuara në web-faqe të KRPP-së.**

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që aktivitetin ta kthejë në rivlerësim dhe ta anuloj Njoftimin e datës 12.11.2020.

3. Ky vendim i korigjuar hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Papenburg Adriani" me datë 14.11.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: " **Rikonstruimi i rrugës Isa Kastrati**", dhe me numer të prokurimit 616 20 126 521

Autoriteti Kontraktues, me datë 18.11.2020 ka rishqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi juaj është i bazuar në dispozitat ligjore respektivisht në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për prokurim publik, pasi që tenderuesi i propozuar ndryshimet e bëra në regjistrimin e biznesit nuk i ka përditësuar në Platformën e prokurimit elektronik E Prokurimi ashtu si që është përcaktuar në nenin 3.12. të RRUOPP-se.

-Poashtu është i bazuar pretendime se marrëveshja e konzorciumit nuk është nënshkruar nga lideri i grupit.

Bazuar ne këto sqarime konstatoj se aktiviteti duhet te kthehet ne rivlerësim dhe vlerësimi te behet ne pajtim me nenin 3.12 te RRUOPP-se.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës ,
- Departamentit të prokurimit; dhe
- Njësisë së kërkesës.

Zekë Bardhaj
Zyrtari përgjegjës i Prokurimit

